



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-13277 dt. 10/04/ 2025

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19.03.2025, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi Bekim Lestrani-kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa. **Të pranishëm ishin:** anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Malësore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Hamit Kastrati (PDK).

Mungoi: Florentina Elezi-Veliu (VV).
Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më datën 19.02.2025;
2. Raporti për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
3. Raporti vjetor i KRM "Pastrimi", për vitin 2024;
4. Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve-Drenas";
5. Plani lokal i veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
6. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa, dhe gjoba 02 nr.400/03-62198, dt. 28.12.2023;
7. Të ndryshme.
- 8.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, i cili tha se **pika e pestë e rendit është tërheq, sepse është ardhur para kohe, tani është në shqyrtim publik dhe kemi konstatuar që nuk mundet me ardhur në seancë si pikë e rregullt.**

Arben Shala nënkryetar i Komunës, tha se janë tri propozim-vendime, njeri ka të bëjë me parcelën në Krajkovë edhe tjetri është po ashtu në Krajkovë dhe një propozim-vendim është në Negroc.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me tri pikat shtesë që i prezantoi nënkryetari i Komunës dhe me vota unanime kaloi rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës 1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 19.02.2025, diskutime nuk pati dhe kaloi në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 2. Raporti për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023.

Hamit Haxhiu, tha se pasi është raport nuk votohet kështu që unë jam që të rekomandohet për Kuvend si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3. Raporti vjetor i KRM “Pastrimi”, për vitin 2024. Pasi nuk pati vërejtje sugjerime, kryesuesi hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Raporti vjetor i NPL “Stacioni i Autobusëve-Drenas”, ku edhe kjo pikë u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, ashtu siç ju njoftova në fillim të mbledhjes është tërhequr pika e 5. Plani lokal i veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 6. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, 02 nr.400/03-62198 dt. 28.12.2023, pasi nuk pat diskutime edhe kjo pikë u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 7. Propozim-vendim për plotësim - ndryshimin e Rregullores Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit.

Agnesa Bucolli drejtoreshë e Drejtorisë për zhvillim ekonomik, tha se me këtë propozim-vendim bëhet plotësim-ndryshimi i Rregullores nr. 12-313-5709 dt. 31.01.2019. Me kërkesë të baranatoreve që të zgjatet orari i kujdestarive për sezonin veror dhe dimror, orari i punës për barnatore, ordinanca dhe klinika private do të jetë i njëjtë për të dy sezonet dhe fillon prej orës 08:00, ndërsa mbaron në orën 22:00.

Hamit Haxhiu, po e shoh që si plan është hartuar mirë, por ka disa gabime teknike dhe kishte qenë mirë me i bërë barnatoret të kujdestarojnë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e shtatë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 8. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit të ofertës për pronën komunale: P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m².

Azemine Gjoka, deshta me pyet se këto tri propozimet që janë, a kanë me u votuar trijat veq e veq a jan të ndryshme njëra me tjetrën.

Arben Shala nënkryetar i Komunës, tha se janë tri propozim-vendime, të veçanta njeri ka të bëjë me parcelën në Krajkovë edhe tjetri është po ashtu në Krajkovë dhe një propozim-vendim është në Negroc.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha se me vota unanime rekomandohet edhe pika e tetë për Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 9. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit të ofertës për pronën komunale: P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 m².

Arbër Halilaj, unë jam që kjo pikë të shkoj për seancën e radhes vëtëm të jemi të paisur me shumë informacione rreth projektit, me këtë vlerë investive numrin e të punsuarve dhe informata të tjera.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha se me vota unanime rekomandohet për Kuvend edhe kjo pikë e nëntë e rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 10. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit të ofertës për pronën komunale: P-70310053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m².

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën. Të ndryshme, pasi nuk pat diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35.


Procesmbajtësja:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani